



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2024

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: “**M U R A T I**” sh.p.k me adrese: BULQIZE Rruga Ish Keshilli i Rrethit
Bulqize, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur e thjeshtuar - Marreveshje Kuader.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale ndertimi + inerte per ASHPU dhe ASHPR” /Marrëveshje Kuadër me fond limit **9,582,085** (nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dymijë e tetëdhjetë e pesë) **lekë pa t.v.sh.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-95745-02-19-2024

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “M U R A T I” sh.p.k me Nipt: J66702413V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.804.025** (tetëmilion e tetëqind e katërmijë e njëzet e pesë) **lekë** (pa tvsh).

2. “GENERAL TRADING” sh.p.k. me Nipt: M21501011F

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.912.160** (tetëmilion e nëntëqind e dymbëdhjetëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

3. “SAM-ARS 2016” shpk me Nipt: L62629204V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.762.700** (tetëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e shtatëqind) **lekë** (pa tvsh).

Operatore ekonomik te skualifikuar jane operoret ekonomike si me poshte:

SAM-ARS 2016

Operatori ekonomik ka paraqitur nje oferte jo te rregullt pasi ne shtojcen 2, tek lista e cmimeve, ne preventivin e paraqitur ka ofertuar per te njejten artikull me cmime te ndryshme, duke e bere oferten te pavlefshme. Konkretisht per zeret me nr.3 “Granil lavatrice”, nr.4 “Derrase pishe 3*10 cm dhe nr.8 “Gozhde Betoni Ø 7 mm”.

Operatori ekonomik s’kualifikohet per arsyen e mesiperme.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

GENERAL TRADING

1. Operatori ekonomik ka paraqitur nje oferte jo te rregullt pasi ne shtojcen 2, tek lista e cmimeve, ne preventivin e paraqitur ka ofertuar per te njejtin artikull me cmim te ndryshem, duke e bere oferten te pavlefshme. Konkretisht per zerin me nr.8 “Gozhde Betoni Ø 7 mm”.
2. Operatori ekonomik ka paraqitur disa fatura tatimore si furnizime te ngjashme, ku artikulli ne keto fatura ishte “F.V kapak pusetash” i cili ze nje perqindje shume te vogel nga lista e artikujve te kerkuar ne preventiv. Ne objektin tone te prokurimit jane kerkuar dhe artikuj te ndryshem si cemento, rere, gelqere apo gozhda betoni dhe operatori ekonomik nuk ka paraqitur fatura ose kontrata te ngjashme qe lidhen me objektin tone te prokurimit duke mos permbushur piken **2.3.1.**, por ka paraqitur fatura vetem nje artikull.

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vleres se perlloritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimet e leshuara nga nje ent public ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik s’kualifikohet per arsyet e mesiperme.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"M U R A T I" sh.p.k.** me adrese: BULQIZE Rruga Ish Keshilli i Rrethit Bulqize, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1 , se oferta e paraqitur prej **8.804.025** (tetë milion e tetëqind e katërmijë e njëzet e pesë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)** brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuader.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula**